



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prijemni/Pridata Received/Deivety		27 - 11 2023	3 viti god year
Organ /Njesta Organ /Jednitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAPMSH/CIC	7122/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.1229/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1229/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Agjencia e Privatizimit të Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 24.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1229/2023 e datës 02.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

Mbetet në fuqi Vendimi me numër DM687/2023 i datës 28.09.2023 i Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën e punës "Kryesues i Njesisë për Përgatitjen e shitjes, shqyrtimit ligjor dhe tenderimit" në Departamentin e shitjes, në Agjencinë Kosovare të Privatizimit në bazë të Akt Emërimit me numër reference 171/DSH2 të datës 29.12.2022, me datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6303/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër

vendimit me numër DM687/2023 të datës 28.09.2023 të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për shkak të refuzimit të kërkesës për pushim pa pagesë në afat prej 01.10.2023 deri 26.04.2024 përmes njoftimit të datës 28.09.2023 të Burimeve Njerëzore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.10.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa Këshilli më datë 17.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6303/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin nga Burimet Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 28.09.2023; Letra e detyrës së regjistrit Nyc Department of Education e studentit e G.L. i datës 18.07.2023; Vendim i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër DM 687/2023 i datës 28.09.2023; Kërkesë për pushim pa pagesë e datës 27.09.2023; E-mail nga A.L. për A.G. i datës 28.09.2023; E-mail nga M.A. për A.L. i datës 28.09.2023; E-mail nga L.Xh.T. për A.L. i datës 28.09.2023; E-mail nga A.L. për L.Xh.T. i datës 28.09.2023; E-mail i datës 07.09.2023; E-mail nga A.L. për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 30.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.10.2023; Përgjigje në ankesë e datës 17.10.2023; Akt Emërim me numër reference: 171/DSH2 i A.L. i datës 29.12.2022; Përshkrimi i detyrave të punës; Propozim me numër Nr.KR/07/2023 i datës 15.02.2023; Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër DM61/2023 i datës 22.02.2023; Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër DM134/2023 i datës 25.04.2023; Kërkesë për pushim pa pagesë i datës 29.03.2023; E-mail nga A.L. për PetridesFËC@schools.nyc.gov i datës 20.03.2023; E-mail PetridesFËC për A.L. i datës 20.03.2023; E-mail nga A.L. për PetridesFËC@schools.nyc.gov i datës 20.03.2023; E-mail nga A.L. për PetridesFËC@schools.nyc.gov i datës 29.03.2023; E-mail nga A.G. për A.L. i datës 05.07.2023; Kërkesë për pushim pa pagesë i datës 06.06.2023; Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër DM257/2023 i datës 06.07.2023; Kërkesë për pushim pa pagesë i datës 11.07.2023; Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër DM260/2023 i datës 18.07.2023; E-mail nga L.Xh.T. për A.L. i datës 07.09.2023; E-mail nga A.L. për L.Xh.T. i datës 28.09.2023; Kërkesë për pushim pa pagesë i datës 27.09.2023; E-mail nga M.A. për A.L. i datës 28.09.2023; E-mail nga A.L. për L.Xh.T. i datës 02.10.2023; E-mail nga H.H. për A.L. i datës 11.05.2023; Përshkrimi i punës i datës 19.07.2017; Përshkrimi i punës i datës 14.09.2023; E-mail nga L.Xh.T. për C.Z. i datës 15.11.2023; Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër protokolli 3762 i datës 15.11.2023;



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *“Kryesues i Njesisë për Përgatitjen e shitjes, shqyrtimit ligjor dhe tenderimit”* në Departamentin e shitjes, në Agjencinë Kosovare të Privatizimit në bazë të Akt Emërimit me numër reference 171/DSH2 të datës 29.12.2022. Ndërsa sipas vendimit me numër DM61/2023 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ankuesi për shkak të ristrukturimit të institucionit nga data 01.06.2023 është transferuar në pozitën *“Udhëheqës i Divizionit të Marketingut dhe Tenderit Publik”* në Departamentin e Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjeve. Ankuesi me datë 27.09.2023 ka parashtruar kërkesë për pushim pa pagesë tek Drejtori Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me arsyetimin për shkak të përkujdesjes ndaj fëmiut jashtë vendit, përkatësisht Nju Jork SHBA për periudhën e pushimit pa pagesë që do të jetë prej datës 01.10.2023 deri 26.04.2024, i njëjti bazohet në kriteret e përcaktuara sipas Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik përkatësisht në nenin 16 paragrafin 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. Në bazë të kërkesës të zyrtarit publik, udhëheqësi më i lartë administrativ mund të lejojë që zyrtarit publik të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 2. Për realizimin e të drejtës për pushim pa pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni, zyrtari publik duhet të paraqet kërkesën e arsyetuar për pushim pa pagesë.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare e Privatizimit ka nxjerr vendimin me numër DM687/2023 me të cilin ankuesit i ka refuzuar kërkesën për shfrytëzimin e pushimit pa pagesë prej datës 01.10.2023 deri 26.04.2024 me arsyetimin se, pas shqyrtimi të kërkesës së z. Limani si dhe duke pasur parasysh faktet se pezullimi vullnetar bëhet me kërkesë të nëpunësit civil për përkujdesje për të afërmit e moshuar ose të sëmurë (bashkëshorten, bashkëshortin, prindin, fëmijën, motrën, vëllan) për një periudhë deri 1 vjet, bazuar në strukturën e re organizative z. me vendimin me numër DM61/2023 të datës 22.02.2023 është emëruar në pozitën *“Udhëheqës i Divizionit të Marketingut dhe Tenderit Publik”* në Departamentin e Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjeve. Konsiderohet që është më se e nevojshme që zyrtari të jetë prezent në institucion nga data 01.10.2023 për të vazhduar pa ngecje procesi i ri ristrukturimit.

Ankuesi i pakënaqur ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër vendimit me numër DM687/2023 të datës 28.09.2023 të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për shkak të refuzimit të kërkesës për pushim pa pagesë në afat prej 01.10.2023 deri 26.04.2024, i njëjti kërkon që të aprovohet në tërësi ankesa e tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit me numër DM687/2023 të datës 28.09.2023 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka konstatuar se sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik konkretisht neni 70 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 përcakton se: 1. Pezullimi vullnetar bëhet me kërkesë të nëpunëses/it civil në rastet si në vijim: 1.1. për kujdesin anëtares/it të ngushtë të familjes, të



moshuar ose të sëmurë për një periudhë deri në një (1) vit", ndërsa ankuesi kërkesën e datës 27.09.2023 për pushim pa pagesë e ka parashtruar me arsyetimin për shkak të përkujdesjes ndaj fëmiut jashtë vendit, përkatësisht shkollimit të fëmiut në Nju Jork SHBA (fëmija është i moshës madhore në studime në SHBA), si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesa e ankuesit nuk përmbush elementet e përcaktuar me dispozitat e cekura si më lartë.

Bazuar në provat materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë gjegjësisht të Vendimit me numër DM687/2023 të datës 28.09.2023 të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, konstaton se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i këtij vendimi është në pajtim me gjendjen faktike dhe juridike të përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për shkak që kërkesa e ankuesit nuk gjen mbështetje ligjore dhe e njëjta është refuzuar, mirëpo arsyetimi i këtij vendimi nuk është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi sepse nuk janë dhënë arsye konkrete dhe të bazuara në dispozitat ligjore lidhur me refuzimin e ankesës, kështu që Kolegji i Këshillit duke marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht me nenin 132 paragrafin 3 i cili përcakton se: *3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar",* plotëson arsyetimin e këtij vendimi me gjendjen faktike dhe juridike, ngase kërkesa e ankuesit nuk duhet të refuzohet për shkak procesit të ristrukturimit, por kërkesa duhet të refuzohet me arsyetimin që dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik e përcaktojnë sipas nenit 70 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të këtij ligji. Andaj bazuar në rrethanat e lartcekura pretendimet ankimore të ankuesit janë pabazuara dhe nuk kanë mbështetje ligjore siç e përcakton ligji.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.




KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1229/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.